



ASAMBLEJA E PËRGJITHËSHME
E SHOQËRISË
UJESJELLES KANALIZIME POGRADEC SHA

VENDIM

Nr 81 Date 31.03.2023

“PER SHPALLJEN NE LIKUJDIM TE SHOQERISE”

Sot, më datë 31 / 03 / 2023, Ujesjelles kanalizime Pogradec sha, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me kodin unik NIPT J64103615J, mbajti mbledhjen e Asamblesë. Mbledhja u thirr nga likuidatori dhe administratori i shoqërisë zoti Ferdinand Kullolli, për të diskutuar mbi rendin e ditës si vijon:

Çështjet e rendit të ditës:

- Prishja e shoqërisë dhe shpallja e saj në likuidim;
- Emërimi i Likuidatorit.

Në shqyrtim të rendit të ditës, Asambleja vëren:

Shoqëria Ujesjelles Kanalizime Pogradec Sha nuk zhvillon më aktivitete pasi në përputhje me VKM Nr. 302, datë 11.05.2022 si dhe me marrëveshjen noteriale Nr. 2226 Rep. dhe Nr. 1110 Kol, datë 16.09.2022 midis shoqërisë Ujesjelles Kanalizime Pogradec sha dhe shoqërisë “Shoqëria Rajonale Ujësjetelës Kanalizime” Pogradec sha, kjo shoqëri e ka transferuar veprimtarinë ekonomike si dhe aktivet dhe detyrimet e saj në tërësi. Nga data 01.11.2022, kjo shoqëri nuk ka më të drejtë të zhvillojë aktivitetin për të cilin ajo është themeluar.

Për sa konstatohet më sipër, shoqëria e ka përmbushur qëllimin e krijimit dhe nuk ka më arsye të vijoje ekzistencën e saj dhe duhet të priset dhe të cregjistrohet nga regjistri tregtar QKB.

Pasi diskutoi gjerësisht mbi rendin e ditës, Ortaku i Vetëm vendosi:

- (1) Përfundimin e aktivitetit të shoqërisë dhe prishjen e saj
- (2) Shoqëria shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese;
- (3) Emërimin e Z. Ferdinand Kullolli si likuidator të shoqërisë.
- (4) Likuidatori është i autorizuar të përgatisë Raportin Përfundimtar të likuidimit të shoqërisë. Ai është gjithashtu i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për likuidimin e shoqërisë si dhe të kërkojë, paraqesë çdo dokument të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likuidimin e shoqërisë.

Pasi u sigurua se nuk ka më çështje për diskutim, mbledhja mbyllet dhe vendimi nënshkruhet në 3 kopje identike si vijon:

ASAMBLEJA E PËRGJITHËSHME

KRYETARI

ILIR XHAKOLLI

